

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Nr. 2746 / Prot. datë 18.05.2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCEVE
DHE EKONOMISË

Nr. 2723 / Prot. datë 19.5.2020

URDHËR

Nr. 115 , datë 18.05.2020

PËR

**TRAJTIMIN E KËRKESAVE TË PERSONAVE PËR PAJISJE ME PROGRAMET
MËSIMORE LËNDORE TË ZBATUARA NË INSTITUCIONET ARSIMORE TË
ARSIMIT TË MESËM TË LARTË, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË PARA VITIT
SHKOLLOR 2008-2009.**

Në mbështetje të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 26, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të nenit 7 dhe të nenit 10, të ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë".

URDHËROJ:

1. Trajtimin nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) të kërkesave të personave të interesuar për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë, në të cilat përfshihen gjimnazet dhe shkollat e arsimit të mesëm të orientuar
2. Kërkesat e personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë profesional, do të trajtohen nga Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK).
3. Personat që janë regjistruar në gjimnaze dhe në shkollat e arsimit të mesëm të orientuar para vitit shkollor 2008-2009 dhe kërkojnë të pajisen me programet mësimore lëndore, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim në ASCAP, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

4. Personat që janë regjistruar në arsimin e mesëm të lartë të profesional para vitit 2008-2009 dhe kërkojnë të pajisen me programet mësimore lëndore, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim në AKAFPK, shoqëruar me dokumentacionin përkatës.
5. ASCAP dhe AKAFPK, do të trajtojnë vetëm ato kërkesa, të cilat janë të shoqëruara me dokumentacionin shkollor dëftesë, certifikatë, dëshmi origjinale ose kopje të noterizuara apo vërtetime të lëshuara nga zyrat e arkivës shtetërore, sipas kërkesave të secilit institucion.
6. ASCAP e pajis personin me një përmbledhje sintetike të programeve lëndore, e cila përmban orët mësimore dhe njohuritë kryesore për secilën lëndë, sipas klasave përkatëse plotësuar me siglën, nënshkrimin dhe miratimin e ASCAP.
7. AKAFPK e pajis personin me një përmbledhje sintetike të programeve të lëndëve të përgjithshme, lëndëve profesionale dhe praktikave profesionale, plotësuar me siglën, nënshkrimin dhe miratimin e AKAFPK.
8. ASCAP përcakton formatin e përmbledhjes sintetike të programeve të arsimit të mesëm të lartë të përgjithshëm dhe të orientuar, si dhe formatin e programeve sintetike të lëndëve të kulturës së përgjithshme, të arsimit të mesëm të lartë profesional.
9. AKAFPK përcakton formatin e programeve sintetike të lëndëve dhe praktikave të kulturës profesionale, të arsimit të mesëm të lartë profesional.
10. ASCAP, brenda 30 ditë pune nga miratimi i këtij urdhri, në përputhje me rregulloren dhe procedurat e brendshme të këtij institucioni, harton/rigjeneron programet sintetike të lëndëve të arsimit të mesëm të lartë të përgjithshëm, të arsimit mesëm të orientuar, si dhe programet sintetike të lëndëve të kulturës së përgjithshme të arsimit të mesëm të lartë profesional për periudhën para vitit shkollor 2008-2009.
11. ASCAP, brenda 30 ditë pune nga miratimi i këtij urdhri, dërgon zyrtarisht me proces-verbal në AKAFPK përmbledhjen sintetike të programeve të lëndëve të kulturës së përgjithshme të arsimit të mesëm të lartë profesional për periudhën para vitit shkollor 2008-2009.
12. Të gjitha programet e lëndëve profesionale të arsimit të mesëm të lartë profesional të periudhës para vitit shkollor 2008-2009, që ndodhen në arkivën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe në arkivën e ASCAP, brenda 30 ditë pune nga miratimi i këtij urdhri, të transferohen zyrtarisht me proces-verbal pranë AKAFPK.
13. AKAFPK, brenda 30 ditë pune pasi ka marrë zyrtarisht me protokoll nga ASCAP përmbledhjen sintetike të programeve të lëndëve të kulturës së përgjithshme të arsimit të mesëm të lartë profesional dhe programet sintetike të kulturës profesionale të arsimit të mesëm të lartë profesional të periudhës para vitit shkollor 2008-09, që ndodhen në arkivën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe në arkivën e ASCAP, në përputhje me rregulloren dhe procedurat e brendshme të këtij institucioni, harton/rigjeneron programet sintetike të lëndëve dhe praktikave të kulturës profesionale të arsimit të mesëm të lartë profesional, të kësaj periudhe.
14. Kopje të dokumenteve të krijuara sipas këtij urdhri ruhen, administrohen dhe arkivohen nga ASCAP dhe AKAFPK, sipas akteve rregullatorë në fuqi.

15. ASCAP fillon trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara para vitit shkollor 2008-2009, në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë të përgjithshëm dhe arsimit të orientuar, pas 30 ditëve pune të miratimit të këtij urdhri.
16. AKAFPK fillon trajtimin e kërkesave të personave për pajisje me programet mësimore lëndore të zbatuara në institucionet arsimore të arsimit të mesëm të lartë profesional para vitit shkollor 2008-2009, pas 30 ditëve pune pasi ka marrë zyrtarisht me protokoll nga ASCAP programet sintetike të lëndëve të kulturës së përgjithshme të arsimit të mesëm të lartë profesional, si dhe programet e lëndëve të kulturës profesionale të arsimit të mesëm të lartë profesional të periudhës para vitit shkollor 2008-2009, që ndodhen në arkivën e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe në arkivën e ASCAP.
17. ASCAP dhe AKAFPK i pajisin personat me dokumentacionin e kërkuar brenda 10 ditëve pune nga dita e protokollimit të kërkesës.
18. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar dhe Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

